



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm KSHPK) në seancën e62-të, të mbajtur më 15.02.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura në lëndën me numër 09-5605/1 nga 11.12.2019, e formuar pas denoncimit kundër personit ///, kandidate e propozuar për ///. **NDËRPRITET.**

Pas kontrollit dhe analizimit të të dhënave, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk është konstatuar shkelje e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pretendimet në denoncim nuk janë vërtetuar, pas së cilës KSHPK nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është duke vepruar për lëndën 09-5605/1 të datës 12.11.2019, i formuar pas kallëzimit të një parashtruesi të njohur me pretendimin për konflikt interesi, pasi pranë I///. "///" në Shkup, në bazë të konkursit të shpallur për zgjedhjen e asistentit për mësimdhënie ///, Komisioni recensues mori vendim dhe i propozoi Këshillit Shkencor të Institutit që të zgjedhë kandidatja /// si asistente në fushën e mësipërme, e cila tashmë ishte e punësuar si asistente në ///.

Në denoncim, parashtruesi i cili është një nga kandidatët që nuk janë përzgjedhur në konkurs, vë në dukje një konflikt interesi të anëtarëve të komisionit shqyrtues, si më poshtë:

Prof. dr. ///, i cili ishte në marrëdhënie të ngushta miqësore me babain e kandidates së propozuar, ///; Prof. Dr. ///, mentor i temës së doktoraturës së kandidatit të propozuar dhe profesor vizitor i studimeve universitare dhe pasuniversitare në Fakultetin ///, në kohën kur babai i kandidatit ishte dekan i fakultetit me të njëjtin emër dhe asoc. Prof. Dr. ///, e punësuar në kohën kur dekan i fakultetit ishte babai i kandidates së propozuar.

Në denoncim gjithashtu thuhet se nuk dihet pse pikërisht këta profesorë përbëjnë komisionin, kur fusha e tyre akademike nuk barazohet me të drejtën e BE-së dhe të drejtat e njeriut.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim, Komisioni Shtetëror arrin në përfundimin se pjesa që ka të bëjë me një konflikt të mundshëm interesi nuk konfirmohet, sepse përshkrimi i dhënë për llojin e marrëdhënies ndërmjet anëtarëve të komisionit shqyrtues dhe kandidatit të propozuar nuk përfshin përkufizimin e personave të afërt të përmendur në nenin 8, paragrafi 4 i /// "Me termin "persona të afërt" nënkuptohen personat në bashkësi martesore ose jashtëmartesore me person zyrtar, të afërm gjaku në vijë të drejtë dhe anësore deri në shkallën e katërt,

të afërm nga martesja deri në shkallën e dytë, si dhe çdo person fizik ose juridik me të cilin personi zyrtar ka interes financiar”..

Lidhur me pretendimet tjera për përbërjen e komisionit, Komisioni Shtetëror i është drejtuar Inspektoratit Shtetëror të Arsimit dhe prej aty si institucion kompetent ka kërkuar inspektim të jashtëzakonshëm lidhur me procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Shqyrtues, i cili ka shqyrtuar dokumentet e kandidatët e paraqitur në Konkursin për përzgjedhjen e asistentit në drejtimet mësimore-shkencore të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe E Drejta e BE-së në ///, “///” në Shkup.

Në afatin e përcaktuar me ligj, Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka njoftuar Komisionin Shtetëror se Inspektorati ka përpiluar procesverbal UP1nr. 09-2939 datë 25.12.2019, në të cilin është konstatuar se nuk ka lëshime lidhur me procedurën e përzgjedhjes së asistentit në ///. “///” në Shkup për fushat mësimore-shkencore - Të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të drejtën e BE-së. Njoftim për gjendjen e konstatuar për rastin konkret i është dorëzuar Avokatit të Popullit të RMV-së, i cili është njohur me rastin nga parashtuesi i denoncimit.

Nga kjo rezulton se pretendimet në denoncim nuk vërtetohen, për çka Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Sipas përfundimit të KSHPK-së,
Punoi: E.N, bashkëpunëtor
Kontrolloi: K.Z., Udhëheqëse
Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së